



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2022

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 10/05/2022

Drejtuar: OE “REDCLOUD” Shpk, me adrese Rruga “Kavajes”, ambient te Zona Kadastrale 8380, Nr. Pasurie 2/98+14-43, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: **E Hapur/ Sherbime.**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-24785-04-12-2022.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Sherbimi per organizimin e eventeve, festave dhe dekorit ne Bashkine Lezhe”.**

Kohëzgjatja e kontratës: **36 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PIANO BISHA” SH.P.K me Nuis K86624002A & “EDUART ULAJ” P/F me Nuis L27719501U, me oferte ekonomike 30,816,570 (tridhjetë million e teteqind e gjashtembedhjetë mijë peseqind e shtatedhjetë) Lek pa Tvsh.
2. Operatori Ekonomik “POWER INDUSTRIES” SH.P.K me Nuis L51706022H, me oferte ekonomike 30,637,828 (Tridhjetë milion e gjashteqind e tridhjetë e shtatë mijë e teteqind e njezet e tete) Lek pa Tvsh,
3. Operatori Ekonomik “REDCLOUD” SH.P.K, me Nuis L11331001C, me oferte ekonomike 30,290,100 (tridhjetë milion e dyqind e nentedhjetë mijë e njeqind) Lek pa Tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "PIANO BISHA" SH.P.K me Nuis K86624002A & "EDUART ULAJ" P/F me Nuis L27719501U,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se BOE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbime e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ose

b-Kur shërbime e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e shërbimeve te ngjashme me vlerë te pakten prej 6,163,314 leke pa tvsh.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se vlera e shërbimeve te ngjashme te paraqitur nga ky BOE eshte prej 5,842,754 leke pa tvsh dhe si rrjedhoje keto shërbime nuk arrijne vleren e 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë

organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PIANO BISHA” SH.P.K & “EDUART ULAJ” P/F, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PIANO BISHA” SH.P.K & “EDUART ULAJ” P/F, skualifikohet.

2- Operatori Ekonomik “POWER INDUSTRIES” SH.P.K me Nuis L51706022H,

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbime të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ose

b-Kur shërbime të ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Theksojmë se për të përmbushur pikën 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacion për realizimin e shërbimeve të ngjashme me vlerë të pakten prej 6,163,314 leke pa tvsh si më poshtë:

a-Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do të vërtetojë duke paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara;

ose

b-Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se OE ka paraqitur dokumentacion për furnizimet (mallra), të meparshme të ngjashme të realizuar nga ana e tij.

KVO thekson se në pikën 2.3.1, të kushteve të veçanta të kualifikimit parashikohet se: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*, dhe si rrjedhojë për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e ngjashme pasi kontrata që AK kërkon të prokurojë është kontratë shërbimi dhe jo malli.

Si përfundim duke qenë se OE nuk ka paraqitur dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nënën 76, pikë 3/a dhe nënën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar nënën 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “POWER INDUSTRIES” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatorit Ekonomik “POWER INDUSTRIES” SH.P.K, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “REDCLOUD” Shpk, me adrese Rruga “Kavajes”, ambient te Zona Kadastrale 8380, Nr. Pasurie 2/98+14-43, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 30,290,100 (tridhjetë milion e dyqind e nentëdhjetë mijë e njëqind) Lek pa Tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU